



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosovo

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Raporti vjetor për vitin 2013



Prishtinë, Mars 2014

HYRJE

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, bazuar në Ligjin Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjin Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet është i obliguar që brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga përfundimi i çdo viti kalendarik, të përgatisë dhe dorëzojë Kuvendit të Republikës së Kosovës një raport vjetor, i cili:

- analizon gjendjen e industrisë minerare në Kosovë; dhe
- bën një përmbledhje të të gjitha masave rregullore, hetuese dhe zbatuese të marra nga KPMM gjatë vitit përkatës kalendarik

Qëllimi i përgjithshëm i funksionimit të KPMM-së është: promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore, i hulumtimit, shfrytëzimit dhe përpunimit- pasurimit të mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të të dhënave gjeo-shkencore në funksion të zhvillimit ekonomik për të mirën e Republikës së Kosovës. Përderisa ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e realizuar në bazë të këtyre qëllimeve.

Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetin e bërë në fushën e gjeologjisë - hulumtimit, xehetarisë - shfrytëzimit, përpunimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat e parapara për të ardhmen.

Struktura dhe përmbajtja e këtij raporti në krahasim me strukturën e vitit të kaluar në përgjithësi ka ndryshuar pas rekomandimeve dhe bashkëpunimit që kemi pasur me Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP), qëllim i të cilit ka qenë harmonizimi i strukturës dhe përmbajtjes së raportit për të gjitha institucionet që i raportojnë për punën e tyre një vjeçare Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Për një rishikim të fokusuar të çështjeve relevante, ne kemi organizuar raportin në këtë formë:

1. Përmbledhja ekzekutive, është pjesë e cila përshkruan në tërësi raportin dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të Institucionit;
2. Baza Ligjore, në të cilën është e paraqitur gjithë baza ligjore që rregullon funksionalitetin e institucionit, si dhe vështirësitë ligjore në zbatimin e përgjegjësi të veta;
3. Përshkrimi i Institucionit, i cili përmban përveç tjerash misionin, vizionin, qëllimin dhe kompetencat e KPMM-së, të parapara me Ligjin për Minierat dhe Mineralet, po ashtu përshkruan organizmat me përgjegjësi kryesore në punën e KPMM-së.
4. Organizimi Institucional, është pjesa në të cilën paraqiten format dhe mënyrat e organizimit të brendshëm, në veçanti përmban të dhëna për Bordin, ekzekutivin dhe personelin e KPMM-së, në përgjithësi;
5. Përshkrimi i fushës që e mbulon KPMM, ky kapitull pason me përshkrimin e fushë-veprimtarisë të cilën e mbulon, me rëndësi të veçantë, krahasimin e realizimit të planeve, veprimeve të ndërmarra dhe sfidat e tejkaluara dhe të planifikuara për të ardhmen;

6. Puna gjatë vitit paraprak, janë te fokusuara punët specifike të realizuara gjatë vitit 2013, si dhe, sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak;
7. Raporti Financiar, është prezantuar buxheti dhe shpenzimet për vitin 2013, i shpalosur me detaje sipas kategorive dhe aktiviteteve të caktuara;
8. Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, në këtë pjesë të raportit vjetor janë të prezantuara komentet e ZAP-it dhe adresimi i tyre nga menaxhmenti i KPMM-së, për raportin e auditimit të vitit paraprak; dhe
9. Anekset, është pjesa e fundit e cila përmban të dhëna shtesë të prezantuara në formë të ndryshme të përshtatura sipas natyrës dhe qasjes së informatës ose të të dhënës.

ME FAT!

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
PËRMBAJTJA	4
LISTA E TABELAVE	5
LISTA E FIGURAVE.....	6
SHKURTESAT:	8
PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE	9
1. PËRMBLDHJE EKZEKUTIVE	9
2. BAZA LIGJORE	12
Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale.....	12
Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2013	13
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	14
4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL.....	17
5. PËRSHKRIMI I TREGUT/FUSHËS QË E MBULON INSTITUCIONI.....	23
Minierat e Plumb Zinkut (Pb-Zn)	36
Minierat e Niklit (Fe-Ni)	37
Minierat e Kromit – Cr ₂ O ₃	38
Projektet e realizuara	40
Përpilimi i 4 (katër) plansheteve të hartave gjeologjike në shkallë 1 : 25 000	40
Përpilimi i planit të Menagjimit të Resurseve Minerale të Kosovës.....	41
6. PUNA GJATË VITIT PARAPRAK.....	47
Licencat për hulumtime gjeologjike (kërkim-zbulim).....	57
Licencat e shfrytëzimit.....	62
Lejet për Aktivitetet e Veçanta	66
7. RAPORTIMI FINACIAR	75
8. RAPORTIMI RRETH KOMENTEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	88
9. ANEKSET	94

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2013	12
Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2013	21
Tabela 3: Rezervat e shfrytëzuara për material Jo metalore dhe Energjetike 2013	23
Tabela 4: Sasia e shfrytëzuar e xehes së Pb-Zn në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	36
Tabela 5: Sasia e shfrytëzuar e xehes së Fe-Ni në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	37
Tabela 6: Sasia e shfrytëzuar e xehes së Cr ₂ O ₃ në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	39
Tabela 7: Largimi i djerrinës periudha 2010-2013	44
Tabela 8: Realizimi i largimit të djerrinës në minierën KEK-ut ne periudhën 2010-2013	45
Tabela 9: Gjendja e lëndimeve në Minierën “Trepça” në Stan Tërg	48
Tabela 10: Gjendja e lëndimeve në Minierën “Trepça” në Artanë.....	50
Tabela 11: Gjendja e lëndimeve në Minierën “Trepça” në B.Bërdo-Cërnac	51
Tabela 12: Gjendja e lëndimeve në KEK	52
Tabela 13: Gjendja e lëndimeve në Minierën “Newco - Ferronikeli”	53
Tabela 14: Gjendja e lëndimeve në Guroret tjera.....	54
Tabela 15: Licencat/lejet e lëshuara për vitin 2013	56
Tabela 16: Licencat e lëshuara për hulumtim	57
Tabela 17: Numri i licencave për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	59
Tabela 18: Numri i licencave për mbajtjen e të drejtave	60
Tabela 19: Numri i kërkesave të refuzuara për hulumtim sipas llojeve të lëndëve minerale	60
Tabela 20: Lista e kërkesave të refuzuara në vitin 2013	60
Tabela 21: Licencat e shfrytëzimit të lëshuara në vitin 2013.....	62
Tabela 22: Numri i licencave për shfrytëzim sipas llojeve të lëndëve minerale	64
Tabela 23: Numri i licencave për interes publik	64
Tabela 24: Numri kërkesave të refuzuara për mos-plotësimin e kushteve ligjore.	65
Tabela 25: Numri i aplikacioneve për licenca të shfrytëzimit të refuzuara sipas lëndës minerale	66
Tabela 26: Kërkesat e aprovuara për bartje te kontrollit.	66
Tabela 27: Lista e lejeve per aktivitete të veçanta të lëshuara gjate vitit 2013	67
Tabela 28: Lista e lejeve të lëshuara për vitin 2013 për leje për aktivitete të veçanta	69
Tabela 29: Numri kërkesave të refuzuara për mos-plotësimin e kushteve ligjore.	72
Tabela 30: Lista e kërkesave të refuzuara për vitin 2013 për leje për aktivitete të veçanta	72
Tabela 31: Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2013	75
Tabela 32: Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2013.	76
Tabela 33: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2013.....	77
Tabela 34: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2013	79
Tabela 35: Buxheti i planifikuar dhe i shpenzuar për mallra dhe shërbime në vitin 2013.....	80
Tabela 36: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitë në vitin 2013	81
Tabela 37: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2013.....	81
Tabela 38: Krahësimi i shpenzimeve për vitet 2013-2010.....	82
Tabela 39: Vizitat jashtë vendit që janë realizuar ne vitin 2013	83
Tabela 40: Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.	84
Tabela 41: Inkasimi i te hyrave për vitin 2013	85
Tabela 42: Planifikimi i te hyrave për vitin 2013 dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2013.....	86
Tabela 43: Inkasimi i te hyrave per vitet 2013-2010:	86
Tabela 44: Rekomandimet dhe niveli i zbatueshmërisë	88

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organogrami i KPMM-së	19
Figura 2. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së.....	20
Figura 3. Lokacioni i KPMM-së	22
Figura 4. Rezervat e shfrytëzuara për material Jo metalore dhe Energjetike 2013.....	23
Figura 5. Sasia e shfrytëzuar e linjtit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	24
Figura 6. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e lignitit e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013.....	25
Figura 7. Sasia e shfrytëzuar e andeziteve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	25
Figura 8. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e andezitit e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013	26
Figura 9. Sasia e shfrytëzuar e argjilës në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	26
Figura 10. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e argjilës e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013	27
Figura 11. Sasia e shfrytëzuar e gëlqerorëve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	27
Figura 12. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e gëlqerorëve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	28
Figura 13. Sasia e shfrytëzuar e bazaltit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	28
Figura 14. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e bazaltit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013	29
Figura 15. Sasia e shfrytëzuar e rërës dhe zhavorit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	29
Figura 16. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rërës dhe zhavorit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	30
Figura 17. Sasia e shfrytëzuar e rërës kuarcore në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	30
Figura 18. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rërës kuarcore e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013	31
Figura 19. Sasia e shfrytëzuar e dunitit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	31
Figura 20. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e dunitit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013	32
Figura 21. Sasia e shfrytëzuar e mergelës në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	32
Figura 22. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e mergelës e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	33
Figura 23. Sasia e shfrytëzuar e rreshpeve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	33
Figura 24. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rreshpeve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	34
Figura 25. Sasia e shfrytëzuar e proluvioneve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	34
Figura 26. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e proluvioneve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	35
Figura 27. Sasia e shfrytëzuar e xehes së Pb-Zn në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013.....	36
Figura 28. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e Pb-Zn e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013.....	37
Figura 29. Sasia e shfrytëzuar e xehes së Fe-Ni në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	38
Figura 30. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e Fe-Ni e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013	38
Figura 31. Sasia e shfrytëzuar e xehes së Cr ₂ O ₃ në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013	39
Figura 32. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e Cr ₂ O ₃ e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013	40
Figura 33. Harta gjeologjike e Planshetit Gadishë K34-55 Da në shkallë 1 : 25 000	41
Figura 34. Eskavatori rotorik gjatë punës në minierën e KEK-ut	43
Figura 35. Planifikimi-prodhimi i largimit të djerrinës periudha 2010-2013.....	45
Figura 36. Largimi i djerrinës nga minierat e KEK-ut në periudha 2010-2013	46
Figura 37. Realizimi i minimeve sipërfaqësore periudha 2010-2013	47
Figura 38. Diagrami i lëndimeve në Minierën “Trepça” në Stantërg, periudha (2010–2013)	49
Figura 39. Diagrami i lëndimeve në Minierën “Trepça” në Artanë, periudha (2010–2013)	50
Figura 40. Diagrami i lëndimeve në Minierën “Trepça” në B.Bërdo-Cërnac, periudha (2010–2013).....	51
Figura 41. Diagrami i lëndimeve në KEK, periudha (2010–2013).....	52
Figura 42. Diagrami i lëndimeve në “Newco Ferronikeli”, periudha (2010–2013).....	53
Figura 43. Diagrami i shfrytëzuesve ilegalë, periudha (2010–2013).....	54
Figura 44. Pranimi i aplikacioneve sipas muajve	55
Figura 45. Licencat/lejet e lëshuara gjatë vitit 2013	56
Figura 46. Grafiku i lejeve të lëshuara gjatë vitit 2013	70
Figura 47. Grafiku i kërkesave të refuzuara gjatë vitit 2013	71
Figura 48. Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2013	75
Figura 49. Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2013	76

Figura 50. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2013	78
Figura 51. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2013	79
Figura 52. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalë në vitin 2013	81
Figura 53. Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Projektet Kapitale në vitin 2013	82
Figura 54. Krahësimi i shpenzime për vitet 2013-2010	83
Figura 55. Pjesëmarrja, akomodimi, ushqimi, mëditjet, biletat dhe shpenzimet tjera.....	85
Figura 56. Inkasimi i te hyrave për vitin 2013	85
Figura 57. Planifikimi i te hyrave për vitin 2013 dhe inkasimi i te hyrave për vitin 2013	86
Figura 58. Inkasimi i te hyrave për vitet 2013-2010.....	87

SHKURTESAT:

Esh	Eskavator dregllajn
Fe-Ni	Ferronikeli
IGJK	Instituti Gjeologjik te Kosovës
INDEP	Instituti për Politika Zhvillimore
ISO 9001:2008	Standardi Ndërkombëtar për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Kosovo Force
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operator Ekonomik
Pb-Zn	Plumb-Zink
PMRM	Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale
SJP	Sibovci Jug Perëndimor
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE

1. PËRMBLUDHJE EKZEKUTIVE

1.1 Themelimi

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr.03/L-163 Për Minierat dhe Mineralet si dhe Ligjin Nr. 04/ L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet, me aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këtë ligj, dhe Strategjinë Minerare. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas ligjit për minierat dhe mineralet.

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori i cili ka mandat 3 (tre) vjeçar. Struktura dhe stafi tjetër i KPMM-së, përbëhet nga departamentet kryesore me staf profesional dhe departamentet ose njësitë tjera mbështetëse me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara. Numri i përgjithshëm i te punësuarve në KPMM gjatë vitit 2013 ishte rreth 72 të punësuar.

Me 02 maj 2013 ka hy ne fuqi Ligji Nr. 04/ L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/l-163 për Minierat dhe Mineralet, pas dekretimit nga presidentja e Republikës së Kosovës znj. Atifete Jahjaga me 18.04.2013.

1.2 Progresi

- Gjatë vitit 2013 Bordi i KPMM-së ka mbajtur 19 takime, në të cilat janë shqyrtuar 225 kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë kërkesat e kompanive që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe kërkesat e kompanive të pranuar para vitit 2013).

- KPMM gjatë vitit 2013 ka pranuar gjithsej 122 kërkesa për licenca dhe leje për aktivitete të veçanta.
- Pas procedimit të të gjitha aplikacioneve të lartcekura sipas procedurave të parapara me rregullativën ligjore në fuqi, brenda vitit 2013 janë lëshuar 178 Licenca dhe Leje.
- Po ashtu janë lëshuar edhe 9 Licenca dhe Leje tjera (Licenca për mbajtjen e të drejtave, Licenca për shfrytëzim zejtar dhe Licenca ose Leja në Interes të Publikut),
- Ndërsa ka refuzuar për mos përmbushje të **Kriterit të dhënies 70** kërkesa për licenca dhe leje (Hulumtim 35, Shfrytëzimi 19 dhe Leje për Aktivitet të Veçantë 16).

- “Gjatë vitit 2013 janë inspektuar kompanitë legale sipas rregullave dhe procedurave të parapara për Inspektim të rregullt vjetore, nga Inspektorati i Minierave dhe shërbimet tjera. Gjithashtu janë identifikuar 47 operues ilegal, ndaj të cilëve janë ndërmarra masat e nevojshme të parapara për veprimtarin ilegale në fushën e Minierave”.

- Janë realizuar një mori projektsh, në funksion të realizimit dhe rritjes së efikasitetit të detyrave dhe përgjegjësisë të KPMM-së në përgjithësi, ndër to mund t'i veçojmë:

- Përpilimi i 4 (katër) plansheteve të hartave gjeologjike në shkallë 1 : 25 000;
- Përpilimi i Planit të Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës;
- Në Vitin 2013 KPMM, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm, rritjes së efikasitetit dhe efektshmërisë së përmbyshjes së detyrave dhe përgjegjësisë, ka bere ngritjen dhe funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe certifikimin e tij sipas standardit ISO 9001:2008.

- Janë rritur të hyrat nga kategoria e rentës minerare për 300% ose për rreth 18 mil € në raport me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar.

1.3 Sfidat që e kanë përcjell punën e KPMM-së

Punën dhe aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2013 e kanë përcjell një mori vështirësi të cilat në raste të caktuara kanë ndikuar në uljen e efikasitetit të punës së këtij institucioni mjaftë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës

- Mos harmonizimi i ligjeve tjera me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe Ligjin Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe mos zbatimi i tyre nga institucionet përkatëse. Ne veçanti:

- Mos harmonizimi me Ligjin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar;
- Mos harmonizimi me Ligjin nr. 04/l-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim;
- Shqiptimi i masave joadekuate nga gjykatat kompetente në raport me veprën penale gjë që nuk e ka efektin e duhur ligjor në të shumtën e rasteve;

- Shfrytëzimet ilegale dhe mosrespektimi i standardeve ambientale nga operuesit. Efektet negative që janë duke shkaktuar operuesit ilegalë janë të shumëfishta, duke filluar nga:

- Shkatërrimi i ambientit;
- Dëmtimi i konkurrencës ose operatorëve të licencuar;
- Rritja e numrit të lendeve ose rasteve neper gjykata;
- Shqiptimi i një numri të madh gjobash si dhe rritja e borxheve ndaj KPMM-se;
- Kanosja, pengimi dhe rrezikimi i stafit të terrenit, Etj

- Mos funksionimi i Laboratorit gjegjësisht mos zbatimi i marrëveshjes nga Instituti Gjeologjik të Kosovës (IGJK) për transferimin e këtij shërbimi në këtë institucion;

- Në mungesë të objektivit të përhershëm publik, KPMM vazhdon të mbetet e akomoduar në objekte private dhe në mungesë të hapësirës së mjaftueshme për veprim;

1.4 Planet

KPMM, parasheh që të rris efikasitetin dhe efektivitetin e detyrave dhe përgjegjësive te veta në të ardhmen përmes ngritjes se sistemit te kontrollit te brendshëm në përgjithësi dhe objektivave te caktuara në veçanti:

- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;
- Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit të punës dhe sigurisë në punë te kompanitë e licencuara;
- Ne koordinim dhe në përputhje me misionin dhe objektivin strategjik te Republikës se Kosovës për Integritim Evropiane do behet harmonizimi i standardeve teknike me ato evropiane;
- Rritja e investimeve të huaja përmes pjesëmarrjes dhe organizimit te konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ne vazhdimësi, ngritjen e nivelit te të hyrave nga renta minerare dhe zvogëlimi i llogarive te arkëtueshme;
- Ngritja e nivelit të shërbimeve për palët te treta përmes ofrimit te asistencës teknike dhe profesionale nga KPMM-ja, dhe
- Zbatimi i politikave te cilësisë, nëpërmjet zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, sipas standardit ISO 9001:2008.

2. BAZA LIGJORE

Komisioni i Pavarur per Miniera dhe Minerale

KPMM është themeluar me Rregulloren Nr. 2005/2 e cila ka hy ne fuqi me daten 21 janar 2005 e cila eshte ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-081 për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2005/2 të dates 13 qershor 2008 ku përcaktohet si Agjenci e Pavarur në përputhje me nenin 119 paragrafi 5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës .

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale veprimtarinë e vet e zhvillon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i cili nga data 27 gusht 2010 ka hyrë në fuqi dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet i cili ka hyrë në fuqi me 02 maj 2013.

KPMM-ja rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra dhe Strategjinë Minerare, e cila vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, dhe Ligjit Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Duke u mbështetur në këtë KPMM ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të siguruar: hulumtimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e rregullt të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare, lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e licencave dhe lejeve, themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna tjera ekonomike, nxjerr rregulla për organizimin dhe veprimtarinë e mbrendeshme te KPMM-se, i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Republikën e Kosovës.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura aktet e brendshme nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2013.

Tabela 1: Aktet nënligjore të nxjerrura në KPMM gjatë periudhës 2010-2013

Udhëzime Administrative / Rregullore 2010
KPMM 2010_01 Rregullore per procedurat e shqyrtimit te ankesave
KPMM 2010_02 UA Per Uniformat dhe pajisjet mbrojtese
KPMM 2010_04 UA Caktimi i metodologjise për caktimin e gjobes per operues ilegal
Udhëzime Administrative / Rregullore 2011
KPMM 2011_01 UA Për personat për gjegjes te kompanitë
KPMM 2011_03 UA Për shpenzimet minimale te hulumtimit
Udhëzime Administrative / Rregullore 2012
KPMM 2012_02 UA Për dënimet mandatore
KPMM 2012_03 UA Për blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e mallrave ne KPMM
KPMM 2012_04 UA Rregullat dhe tarifat për palët e treta te kryera nga arkiva e KPMM-se
Udhëzime Administrative / Rregullore 2013
KPMM 2013_01 UA Për shtyrjen e pagesës se rentës minerare

Vështirësitë me të cilat është ballafaquar KPMM gjatë vitit 2013

Mos harmonizimi i ligjeve tjera me Ligjin Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjin Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Gjatë punës së përditëshme në zbatimin e dispozitave ligjore, KPMM ka hasur në disa pengesa rreth sigurimeve dhe garancioneve që Ligji për Minierat dhe Mineralet i ka paraparë për kompanitë e licencuara, kurse garancione u jan kërkuar edhe nga ana e Agjencionit të Pyjeve të Kosovës në rastet kur kultura është mal.

Në nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet është kompetencë ekskluzive e Inspektorëve të KPMM-së sekuestrimi i mjeteve të punës dhe mineraleve të nxjerra, që gjenden në vendin e rastit të veprimit ilegal.

Lidhur me këtë çështje kemi hasur në pengesa nga ana e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar, ku me rastin e sekuestrimit të mjeteve të punës-makinerive, duke kërkuar vendim të veçantë nga Gjykata kompetente për të pranuar makineritë e sekuestruara. Këtë çështje e kemi sqaruar edhe me një shkresë nga Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, i cili e ka sqaruar se nuk ka nevojë për vendim të veçantë nga gjykatat sepse dispozitat e Ligjit Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjit Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet e cekin shprehimisht se është kompetencë e KPMM-së sekuestrimi i mjeteve në rastet e veprimit ilegal. Problem në vete paraqet edhe çështja e zhvillimit të procedurës ligjore nëpër gjykata duke i lënë lëndët të vjetërsohen si dhe shqiptimi i masave joadekuate në raport me veprën penale të kryer duke iu shqiptuar denime me kushte për veprimet ilegale, gjë që nuk e ka efektin e duhur ligjor në shumë raste.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 Vizioni

Zhvillimi i resurseve minerare dhe zgjerimi e modernizimi i industrisë së përpunimit mineral për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për qytetarët e Republikës së Kosovës.

3.2 Misioni

Krijimi i të gjitha kushteve ligjore dhe institucionale për rritjen e shpejte të investimeve në sektorin mineral, forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, rritjen e interesit të komunitetit dhe garantimin e qëndrueshmërisë mjedisore.

3.3 Fushëveprimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. KPMM rregullon aktivitetet minerare në Kosovë në përputhje me Ligjin Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Minalet, si dhe Ligjin Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me këto ligje, dhe Strategjinë Minerare.

3. KPMM vepron në interes të publikut dhe i ushtron në mënyrë të pavarur kompetencat dhe funksionet të cilat i janë dhënë sipas Ligjit Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Minalet, si dhe Ligjit Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet.

4. Nëse një person ushtron ose tenton të ushtrojë dikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në KPMM-në, në, personelin ose menaxhmentin e saj paraqet vepër penale dhe shkelje të ligjit

3.4 Kompetencat dhe Përgjegjësitë e KPMM-së

1. KPMM ka autoritetin e përgjithshëm dhe përgjegjësinë për të siguruar:

1.1. hulumtimin, shfrytëzimin dhe përpunim të rregullt të resurseve minerale në Kosovë dhe shfrytëzimin optimal të resurseve minerale në të gjitha veprimtaritë minerare në përputhje me këtë ligj dhe Strategjinë Minerare;

1.2. Pajtuëshmëria e operimeve minerare me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMM, apo pëlqimeve të lëshuara si parakusht për miratim nga KPMM, në pajtim me ligjet.

KPMM ka kompetencën për ushtrimin e funksioneve në vijim, në përputhje me Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjit Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

1.3. lëshimin, transferimin, vazhdimin, pezullimin dhe revokimin e Licencave dhe Lejeve;

1.4. themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare; dhe

1.5. nxjerrjen e rregullave për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të KPMM-së;

2. KPMM i ofron asistencë teknike Qeverisë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Republikën e Kosovës nëse një gjë e tillë kërkohet nga Qeveria.

3. Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë apo leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me Ligjin Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjin Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

4. KPMM-ja lëshon Licenca dhe Leje pas përmbushjes së kushteve për lëshimin e këtyre Licencave dhe Lejeve në bazë të Ligjit Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjit Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

4.1. Licenca për hulumtim;

4.2. Licenca për mbajtjen e të drejtave;

4.3. Licenca për shfrytëzim;

4.4. Leja për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta;

4.5. Licenca për shfrytëzim zejtar;

4.6. Licenca dhe Leja në Interes të Publikut.

3.5 Përgjegjësit kryesore për menaxhimin e aktivitetit minerar në KPMM

Të gjitha kompetencat e KPMM ushtrohen nga Bordi. Çdo vendim i cili sipas ligjeve në fuqi kërkohet të merret nga KPMM duhet të merret nga vetë Bordi i KPMM. Përderisa Drejtori i KPMM-së drejton veprimtarinë e zakonshme të KPMM-së dhe ushtron të gjitha funksionet e deleguara nga Bordi i KPMM-së.

Megjithatë, KPMM funksionalizimin dhe realizimin efikas dhe efektiv të kompetencave dhe përgjegjësi të veta e realizon përmes organizmave profesional të ngritur në nivele departamentesh. Struktura e KPMM-së përbëhet nga departamentet kryesore dhe departamentet ose njësitë tjera mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së.

Në kuadër të departamenteve me përgjegjësi kryesore bëjnë pjese:

1. Departamenti Inspektoratit të Minierave;
2. Departamenti i Gjeologjisë;
3. Departamenti i Gjeodezisë;
4. Departamenti i GIS-it;
5. Departamenti i Financave;
6. Departamenti Ligjore.

Përderisa si mbështetëse për detyrat dhe përgjegjësitë e KPMM-së, por edhe me përgjegjësi të përcaktuara, bëjnë pjese këto departamente:

1. Departamenti i Administratës;
2. Departamenti i Prokurimit;
3. Departamenti i TI-së; dhe
4. Njësia e Auditimit të Brendshëm

4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

4.1. Organizimi, veprimtaritë, personeli dhe niveli i rrogave

Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe Ligjin Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale e ka të rregulluar strukturën e vet organizative.

4.2. Bordi

KPMM mbikëqyret nga Bordi i cili përbëhet prej 5 anëtarëve, të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë mandat 5 (pesë) vjeçar. Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Bordit, katër prej tyre u ka skaduar mandati me 28.01.2014. Ndërsa anëtari i pestë ka mandat deri me datën 08.12.2015.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/ L-163 për Minierat dhe Mineralet, si dhe Ligjit Nr. 04/L-158, për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, këta anëtarë do të vazhdojnë të qëndrojnë në Bord edhe për një afat tre muajsh.

Bordi i KPMM-së, përveç takimeve të rregullta, me kërkesë të Drejtorit apo të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit organizon edhe takime tjera. Anëtarët e Bordit janë në marrëdhënie të rregulltë pune në KPMM dhe realizojnë detyra të përditshme në përputhje me ligjin në fuqi.

Për marrjen e një vendimi në Bord, Drejtori dhe stafi tjetër profesional përgatisin dhe shqyrtojnë kërkesat veç e veç sipas departamenteve, pastaj përmes takimeve të para-bordit bëhet seleksionimi i kërkesave që i plotësojnë kriteret për t'u përcjellë në Bord, në përputhje me ligjet në fuqi.

Gjatë vitit 2013 janë mbajtur **19** takime të Bordit në të cilat janë shqyrtuar **225** kërkesa për licenca dhe leje (në këtë numër janë përfshirë edhe kërkesat e kompanive që janë shqyrtuar më tepër se një herë si dhe kërkesat e kompanive të pranura para vitit 2013), ku prej tyre kanë qenë:

- 84 kërkesa për Licenca të hulumtimit,
- 65 kërkesa për Licenca të shfrytëzimit,
- 76 kërkesa për Leje dhe aktivitete të veçanta,

Detajet e hollësishme rreth punës së Bordit për vitin raportues, mbledhjet e Bordit, vendimet e marra, arsyetimet për vendimet e marra, janë të paraqitura në Kapitullin 6, Puna gjatë vitit paraprak.

4.3. Ekzekutivi

Me pjesën ekzekutive të KPMM-së udhëheq Drejtori. Drejtori është përgjegjës për të gjitha çështjet ekzekutive brenda KPMM-së, i cili bënë organizimin e takimeve të bordit, përgatitjen e raporteve sipas kërkesave për mbledhjet e Bordit dhe merret me ekzekutimin e vendimeve të marrura nga Bordi. Drejtori i KPMM-së bazuar në legjislacionin në fuqi ka mandat 3 vjeçar. Menaxhmenti i mesëm në KPMM janë drejtorë të departamenteve dhe janë nëpunës civilë. Sipas ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nëpunësit civilë janë punëtorë të karrierës me afat të pacaktuar.

Në figurën më poshtë është paraqitur organogrami i KPMM-së.

4.4. Burimet Njerëzore

Me Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, KPMM-së i janë aprovuar 79 pozita. Deri në fund të vitit 2013 KPMM ka arritur t'i plotësojë 71 pozita. Pozitat tjera për vitin 2013 nuk janë plotësuar në mungesë të mjeteve financiare.

KPMM ka personel me kuadër të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafikun në vijim.




Figura 2. Paraqitja grafike e kualifikimit të personelit të KPMM-së

Niveli i pagave të stafit në KPMM është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Anëtarët e Bordit janë staf politikë të emëruar, dhe pagat e tyre janë të përcaktuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të cilat që nga viti 2007 nuk kanë ndryshuar. Drejtori dhe stafi tjetër ekzekutiv janë nëpunës civilë dhe pagat i kanë të përcaktuara sipas legjislacionit për shërbyes civilë (me koeficientë). Për shkak të natyrës specifike të punës së KPMM-së, përveç pagës bazë, stafi i KPMM-së ka të aprovuara nga MF dhe Kuvendi i Kosovës edhe shtesa në pagë, sipas specifikave të punës për pozita.

Gjatë vitit 2013 një numër i punëtorëve të KPMM-së ka marrë pjesë në trajnime si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur detajet e trajnimeve të stafit të KPMM-së të realizuara gjatë vitit 2013:

Tabela 2: Pjesëmarrja e stafit të KPMM-së në trajnime gjatë vitit 2013

Emri e Mbiemri i pjesmarrësit	Ofruesi i Trajnimit	Lloji i trajnimit	Vendi	Kohezgjatja
Bashkim Zeqaj	BM Event Consulting	Procedurat Dicipinore dhe Procedurat e Ankesave në Shërbimin Civil	Durrës	07-10/02/2014
Fahri Sheqiri	BM Event Consulting	Procedurat Dicipinore dhe Procedurat e Ankesave në Shërbimin Civil	Durrës	07-10/02/2014
Ediz Xhemili	BM Event Consulting	Procedurat Dicipinore dhe Procedurat e Ankesave në Shërbimin Civil	Durrës	07-10/02/2014
Vjollca Gjonbalaj	KMI	Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar dhe harmonizimi i tij me acquis communautaire	Stamboll	20-23/03/2013
Fahri Sheqiri	IKAP	Sjellja me bashkëpunëtor të vështirë	Prishtinë	03/04/2013
Ediz Xhemili	IKAP	Sjellja me bashkëpunëtor të vështirë	Prishtinë	03/04/2013
Fatmire Mulaj	Ministria e Financave	Moduli i Blerjeve Zyrtar i Pranimit të Mallit - FreeBalance	Prishtinë	03/09/2013
Midin Bojaxhiu	BM Event Consulting	Organizimi i brendshëm, riorganizimi dhe ristrukturimi në Institucioneve	Durrës	19-22/09/2013
Nuredin Bislimi	BM Event Consulting	Organizimi i brendshëm, riorganizimi dhe ristrukturimi në Institucioneve	Durrës	19-22/09/2013
Selvete Grajqevci	BM Event Consulting	Organizimi i brendshëm, riorganizimi dhe ristrukturimi në Institucioneve	Durrës	19-22/09/2013
Xhejlane Ahmeti	KMI	Rregullat e reja financiare dhe zbatimi i tyre nga organizatat buxhetore	Kemer-Turqi	25-28/09/2013
Selvi Kadriu	KMI	Rregullat e reja financiare dhe zbatimi i tyre nga organizatat buxhetore	Kemer-Turqi	25-28/09/2013
Gani Nekaj	MPJ e Holandës	European Procurement	Holandë	20-26/10/2013
Haradin Gërvalla	AG Consulting	Rregullat e Ministrisë së Financave për mbylljen e vitit fiskal	Durrës	25-28/10/2013
Halit Gara	AG Consulting	Rregullat e Ministrisë së Financave për mbylljen e vitit fiskal	Durrës	25-28/10/2013
Shukrije Rashiti	KMI	Zbatimi i ligjit për administrimin e punës në zyre në institucione dhe ndërmarrje publike	Tiranë	15-18/11/2013
Arta Dulaj	KMI	Zbatimi i ligjit për administrimin e punës në zyre në institucione dhe ndërmarrje publike	Tiranë	15-18/11/2013
Gazmend Morina	SHKÇAK	Kontabilist i Çertifikuar	Prishtinë	2013
Ediz Xhemili	BM Event Consulting	Menaxhimi efektiv i zyrës	Ohër	05-08/12/2013
Fahri Sheqiri	BM Event Consulting	Menaxhimi efektiv i zyrës	Ohër	05-08/12/2013
Bashkim Zeqaj	BM Event Consulting	Menaxhimi efektiv i zyrës	Ohër	05-08/12/2013

4.5. Lokacioni i KPMM-së dhe hapësira fizike e objektit

Objekti i zyreve të KPMM-së ndodhet në Breg të Diellit në rrugën Armend Daci, nr.1 në Prishtinë. Më poshtë është paraqitur harta e lokacionit të objektit të zyreve të KPMM-së.




Figura 3. Lokacioni i KPMM-së

Në mungesë të objektit të përhershëm për zyre, KPMM është e obliguar që merr me qera objekt privat me një hapësirë prej **1300 m²**, i cili përveç shpenzimeve të mëdha të qerasë, nuk i përmbush as kushtet si për nga hapësira e poashtu edhe nga funksionaliteti.

Edhe pse disa herë KPMM iu ka drejtuar institucioneve përkatëse me kërkesë që të vendoset në objektet e institucioneve publike, ende nuk është bërë një zgjidhje, prandaj KPMM vazhdon të qëndrojë me qera në objekte private, që nga viti 2004.

Vlen të theksohet se gjatë viteve 2010-2013, për hapësirë për zyre me qera KPMM ka shpenzuar nga Buxheti i Kosovës shumën prej **292,844.93€**.

5. PËRSHKRIMI I TREGUT/FUSHËS QË E MBULON INSTITUCIONI

Prezantim statistikor i rezervave të shfrytëzuara gjatë vitit 2013 të lëndëve minerale jo metalore dhe energjetike.

Të dhënat mbi planifikimin dhe rezervat e shfrytëzuara vetëm gjatë vitit 2013 për lëndët minerale jo metalore dhe energjetike janë të paraqitura në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 3: Rezervat e shfrytëzuara për material Jo metalore dhe Energjetike 2013

Nr.	Lënda minerale për shfrytëzim	E planifikuar	E realizuar	Realizimi në %	Njësia matëse
1	Andezite	458,440.00	0.00	0.00%	m ³
2	Argjilë	714,700.00	85,133.89	11.91%	ton
3	Gëlqeror	8,425,822.40	4,914,048.70	58.32%	m ³
4	Bazalt	100,000	9,704.70	9.70%	m ³
5	Rërë dhe Zhavorr	55,070.00	25,198.55	45.76%	m ³
6	Rërë kuarcor	180,500	27,371.00	15.16%	m ³
7	Dunite	254,400	1,783,317.21	600.99%	m ³
9	Rreshpe	10,000	4,600.00	46.00%	m ³
11	Mergelë	760,307	411,073.00	54.07%	m ³
12	Lignite	8,080,000	8,219,393.00	101.73%	ton




Figura 4. Rezervat e shfrytëzuara për material Jo metalore dhe Energjetike 2013

Në grafikët e më poshtëm është bërë paraqitja e realizimit sipas lëndëve të veçanta të mineraleve jo metalore dhe energjetike nga 2010-2013. Po ashtu është paraqitur dhe mesatarja

e lëvizshme e shfrytëzimit, për mes së cilës shprehet trendi i lëvizjes së kërkesave për lëndë të veçanta minerale.

Nga grafikët e më poshtëm mund të vërehet se në disa raste të disa lëndë minerale ka ndryshime në sasinë e rezervave të raportuara në këtë raport, në krahasim me vitet paraprake, të prezantuara këto në raportet vjetore të KPMM-së. Këto ndryshime janë shkaktuar ngase disa nga kompanitë kanë raportuar dhe pas përfundimit të raporteve vjetore të KPMM-së. Dhe po sipas obligimeve ligjore kompanitë obligoheshin që raportin vjetor të kompletuar me situacion për rezervat e shfrytëzuar gjatë vitit paraprak ta sjellin brenda 120 ditëve (por sipas ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Minierat dhe Mineralet, tani afati i raportimit është 60 ditë) pas përfundimit të vitit kalendarik, gjë që bëheshin korrigjime të vazhdueshme. Po ashtu të kihet parasysh se disa nga rezervat e shfrytëzuara të argjilës në vitet paraprake, nga kompanitë kanë qenë të raportuara në m³, meqenëse në listatën e rentës minerale argjila është në tonë, atëherë të gjitha rezervat i kemi konvertuar në ton, qka ka shkaktuar ndryshim në numra.




Figura 5. Sasia e shfrytëzuar e lignitit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 6. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e lignitit e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se gjatë vitit 2012 ka pas një rënie të kërkesave e këndej nuk ka shfrytëzim të proluvioneve.




Figura 7. Sasia e shfrytëzuar e andeziteve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 8. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e andezitit e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013

Siç po vërehet nga grafiku i më sipërm kërkesat në nivel vendi për shfrytëzim të andeziteve kanë një tendencë zbritje.




Figura 9. Sasia e shfrytëzuar e argjilës në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 10. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e argjilës e bazuar në prodhimtarinë nga 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për produktet e argjilës kanë një tendencë stabilizimi.




Figura 11. Sasia e shfrytëzuar e gëlqerorëve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 12. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e gëlqerorëve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për gëlqeror kanë një tendencë ngritje.




Figura 13. Sasia e shfrytëzuar e bazaltit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 14. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e bazaltit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për bazalt nuk kanë një stabilitet të vazhdueshëm.




Figura 15. Sasia e shfrytëzuar e rërës dhe zhavorrit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 16. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rërës dhe zhavorrit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për rërë dhe zhavorr nuk kanë një stabilitet të vazhdueshëm, është më rendësi të ceket se kërkesat vendore për këtë lëndë minerale realisht janë më të mëdha se sa këto të paraqitura në grafikët e mësipërm, kjo për arsye se ka një sasi të konsiderueshme të kësaj lëndë që shfrytëzohet ilegalisht. Edhe përkundër angazhimit të madh që ka pasur Inspektorati i KPMM-se, nuk ka arritur që ta ndalë tërësisht veprimtarinë ilegale.




Figura 17. Sasia e shfrytëzuar e rërës kuarcore në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 18. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rërës kuarcore e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për produktet e rërës kuarcore kanë një tendencë stabilizimi.




Figura 19. Sasia e shfrytëzuar e dunitit në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 20. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e dunitit e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për dunitë gjatë vitit 2013 kanë pësuar rritje të pa parashikuar.




Figura 21. Sasia e shfrytëzuar e mergelës në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 22. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e mergelës e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për mergel gjatë vitit 2012 kanë pësuar një rënie të dukshme, por gjatë vitit 2013 ka një rikthim në gjendje të viteve paraprake.




Figura 23. Sasia e shfrytëzuar e rreshpeve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 24. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e rreshpeve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se kërkesat e tregut të brendshëm për rreshpe kanë pas rritje gjatë vitit 2013, duhet shtuar këtu se dhe interesimi i kompanive për tu licencuar për shfrytëzim të kësaj lënde minerale është i vogël.




Figura 25. Sasia e shfrytëzuar e proluvioneve në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 26. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e proluvioneve e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se nga 2012 e këndeje nuk ka shfrytëzim të proluvioneve.

Prezantim statistikor i rezervave të shfrytëzuara gjatë vitit 2013 të lëndëve minerale metalore.

Në Kosovë shfrytëzimi Pb-Zn behët në 4 miniera nëntokësorë dhe atë: Stanterg, Belloberdë, Cernac dhe Artanë. Shfrytëzimi i xehes nga minierat bëhet në sasi të vogël. Në mungesë të shkrites produkti final është koncentrat i Pb dhe Zn, e tërë sasia e koncentratit eksportohet jashtë vendit. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur raportimet nga minierat. Raportimi i minierave për licencat metalore nuk është çdo herë i rregullt, kjo ka shkaktuar që të ketë ndryshime në sasinë e rezervave të raportuara në çdo fund viti, gjë që është përfshirë dhe në raportin vjetor të KPM-së, nga ku mund të vërehen ndryshime në këtë vit në raport me vitet paraprake. Po ashtu dhe kompanitë në çdo fund vit bëjnë raportin përfundimtar që më ligj ishte 120 ditë (por sipas ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Minierat dhe Mineralet, tani afati i raportimit është 60 ditë) nga përfundimi i vitit kalendarik.

Minierat e Plumb Zinkut (Pb-Zn)

Tabela 4: Sasia e shfrytëzuar e xehes së Pb-Zn në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013

Viti	Planifikim sipas kompanisë	Realizimi-(Raportim nga kompania)	Raporti (Planifikim-Shfrytëzim)
	ton		në %
a	b	c	d=100*d/c
2010	204,420.00	185,841.57	90.91
2011	384,090.00	233,115.41	60.69
2012	209,580.00	225,489.86	107.59
2013	284,948.00	247,653.27	86.91




Figura 27. Sasia e shfrytëzuar e xehes së Pb-Zn në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 28. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e Pb-Zn e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka një tendencë rritje të sasisë së shfrytëzuar xehes së Pb-Zn.

Minierat e Niklit (Fe-Ni)

Në Kosovë shfrytëzimi Niklit (Fe-Ni) behët në shfrytëzim sipërfaqësor, gjatë vitit 2013 kanë qenë aktive dy miniera më licencë shfrytëzimi. Xehja e Fe-Ni kalon në produkt final (metal) dhe si i tillë eksportohet. Përpunimi metalurgjik i xehes së Fe-Ni behët në shkritoren e kompanisë Newco Ferronikeli Complex L.L.C.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm është paraqitur sasia e shfrytëzuar e xehes së Fe-Ni në periudhën 2010-2013.

Tabela 5: Sasia e shfrytëzuar e xehes së Fe-Ni në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013

Viti	Planifikim sipas kompanive	Realizimi- (Raportim nga kompanitë)	Raporti (Planifikim-Shfrytëzim)
	ton		në %
a	b	c	d=100*d/c
2010	890,000.00	779,505.69	87.58
2011	760,000.00	683,854.87	89.98
2012	670,262.80	379,151.21	56.57
2013	630,000.00	623,504.20	98.97




Figura 29. Sasia e shfrytëzuar e xehes së Fe-Ni në territorin e Kosovës, gjatë viteve 2010-2013




Figura 30. Prodhimtaria (mesatarja e lëvizshme) e Fe-Ni e bazuar në prodhimtarinë 2010-2013

Nga grafiku i më sipërm vërehet se ka një tendencë zbritje të sasisë së shfrytëzuar xehes së Fe-Ni.

Minierat e Kromit – Cr_2O_3

Në Kosovë shfrytëzimi i Kromit (Cr_2O_3) është me shfrytëzim sipërfaqësor, për momentin kemi vetëm një licencë shfrytëzimi. Xehja e Cr_2O_3 shitet si e sortuar vetëm më dorë, si i tillë eksportohet.

